

DEPARTAMENTI I FARMACISË

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me pedagogë të angazhuar në mësimdhënie në Departamentin e Farmacisë si dhe specialistë të fushës ka parashikuar të zhvillojë aktivitet shkencore përgjatë gjithë vitit akademik 2018-2019, në funksion të edukimit në vazhdim të farmacistëve të diplomuar në programin studimi i integruar Master i Shkencave në "Farmaci", por jo vetëm: departamenti do të organizojë dhe leksione të hapura për Studentë që aktualisht ndjekin studimet si dhe një Konferencë Kombëtarë/Ndërkombëtare vjetore të organizuar në rang Departamenti.:

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Farmacisë planifikon të zhvillojë Konferencën e IX studentore në bashkëpunim me studentët dhe pedagogët e disiplinave të ndryshme. Tematikat synojnë të vendosin në fokus rritje shkencore që ndeshen në të gjitha disiplinat e formimit profesional të farmacistit, ku mund të veçojmë: teknologjia e përgatitjes së barnave, kontrolli i cilësisë së barnave, analiza e lëndëve helmuese (analiza toksikologjike), kontrolli i cilësisë së bimëve mjekësore e aromatike etj.

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Farmacisë planifikon të zhvillojë në Konferencën e V- të Ndërkombëtare .Kjo konferencë do të zhvillohet në bashkëpunim me Urdhërin e Farmacistit të Shqipërisë, Universitetin e Studimeve të Pizës, Itali dhe Universitetin e Studimeve të Napolit " Federico II" Itali. Në këtë konferencë, do të paraqiten rritje inovative të kërkimit shkencor të zhvilluar në Itali dhe Shqipëri; këto punime do të referohen nga Profesore të shquar të Universiteteve partnere Italiane dhe nga Profesore të shquar të fushës akademike shqiptare dhe stafit akademik të Albanian University. Konferenca do të zhvillohet në ambientet e Tirana International Hotel & Conference Center .

Në këtë Konferencë do të prezantohen punime të mirfillta shkencore të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor, të cilat do të botohen në librin e abstrakteve, si dhe në një numër special botimi të revistës Optime të Albanian University.

* Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti Farmacisë planifikon të zhvillojë nga periudha Dhjetor 2018 -Qershor 2019, disa leksione të hapura me pjesëmarrjen e profesorëve të Universiteteve partnere, apo të Albanian University.